



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201700185/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** Rekomandohet marrja e masave për shpejtim gjykimi të çështjes Administrative me Nr.31025003439-86-2016, të ankuesit Y. B. nga Elbasani.

**Drejtuar :** ZKASTRIOT SELITA  
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

**Për dijëni :** ZYlli BLOSHMI  
Fshati Thanë, ish Komuna Gjegjan

ELBASAN

***I nderuar zoti Kryetar,***

Në ankesën e tij datë 14.02.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi Y. B. nga rrethi i Elbasanit, ankohet për shkelje procedurash gjyqësore dhe zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në gjykimin e një çështje gjyqësore kundra Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një vendimi administrativ. Ankuesi nga ana e tij na sqaron se Gjykata Administrative e shkallës së parë Durrës, me vendimin e saj me Nr.288 datë 04.04.2016 ka vendosur pranimin e padisë dhe ndaj këtij vendimi janë ankuar palët dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pa shkaqe ligjore nuk cakton gjykimin e saj duke u justifikuar me ngarkesën e madhe të punës së saj.

Në kuadrin e zbatimit të parimeve të madhe të një gjykimit të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj. Në rastin konkret duke analizuar në tërësi pretendimet e ankuesit Y. B. dhe shqetësimet e tij për shpejtimin e këtij gjykimi ne mendojmë të rekomandojmë marrjen e masave organizative për një gjykim më të shpejtë nga ana juaj duke u bazuar në këto arsyttime : Në nenin 49/2 të Ligjit me Nr.49/2012 Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", thuhet se: "Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga Gjykata ku është paraqitur ankimi.

Në rastin konkret rezulton se dosja e ankuesit Y. B. ndodhet e regjistruar për gjykim në atë Gjykatë, me datën 30.06.2016, dhe akoma nga ana juaj nuk është planifikimi i gjykimit të saj.

Një veprim i tillë konsiderohet shkelje e të drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe nga Gjykata Kushtetuese e R.SH, e cila me vendimin e saj me Nr.81/2015, arsyetohet

se: Ligji synon në thjeshtimin e procedurave ligjore, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe garantimin e mbrojtjes efektive të drejtës së subjektit dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor brenda afateve sa më të shpejta, e të arsyeshme.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave dhe lirive të Njeriut, nga administrata publike", dhe bazuar në kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se, pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandim për vënien në vend të drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të drejtave dhe lirive".

Për sa sipër, ju

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave organizative për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative të ankuesit Y. B., nga Elbasani datë 30.06.2016, sa më shpejt në të ardhmen.

2. Mbi masat e marra nga ana juaj në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të njoftomi me shkrim brenda 30 ditëve.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**